

Legj 2015



2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

MINISTRI I MINISTRAVE  
5219  
345

Nr. 273, datë 1.4.2015

P Ë R

**NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.718,  
DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN  
E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

- a) Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", regjistrohet individi i renditur në shkronjën "a", të listës, "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesës në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida;
- b) Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohen individët e renditur në shkronjën "a", të listës, "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas

ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së,  
për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues me  
organizatën Al-Qaida.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDIRAMA**

MINISTRI I PUNËVE  
TË JASHTME

DITMIR BUSHATI



**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI  
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E  
OKB-së”)

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME  
ORGANIZATËN AL-QAIDA**

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me  
organizatën Al-Qaida”;

1. ALIASKHAB; ALIBULATOVICH; KEBEKOV.

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër,  
mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI  
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E  
OKB-së”)

**D. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME  
ORGANIZATËN AL-QAIDA**

**b) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë  
me organizatën Al-Qaida”;**

1. MUSTAFA; MOHAMED; FADHIL,
2. AHMED; MOHAMMED; HAMED; ALI,
3. SAID; ALI; AL-SHIHRI,
4. HAKIMULLAH; MEHSUD.

Shënim: Gjenealitet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër,  
mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.